



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-CC-2022-14

Vendosi: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
Gjykatës Vidar Stensland, kryegjykatës
Gjykatës Rumen Nenkov
Gjykatëse Romina Inkuti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 10 mars 2022

Gjuha: Anglishte

Titulli i lëndës: Kërkesë Referuese e Kadri Veselit drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Vendimin e Panelit të Gjykatës së Apelit mbi Kundërshtimet e Ngritura ndaj Juridiksionit të Dhomave të Specializuara

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Gjuhën e Punës dhe Procedim të Mëtejshëm

Parashtruesit

Kadri Veseli

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

1. Më 28 shkurt 2022, z. Kadri Veseli ("parashtruesi") i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese një Kërkesë Referuese, që mban datën 28 shkurt 2022 ("Kërkesa Referuese"),¹ bazuar në nenin 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta") dhe nenin 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"). Parashtruesi përfaqësohet nga z. Ben Emerson dhe z. Endru Strong.
2. Më 1 mars 2022, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, në pajtim me nenin 33(3) të Ligjit, caktoi Panelin e mësipërm për të vendosur në lidhje me Kërkesën Referuese.²
3. Në bazë të nenit 20 të Ligjit dhe rregullës 5 të Rregullores së Punës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja"), Paneli vendos gjuhët e punës për procedurat para tij. Paneli vëren se parashtruesi e ka paraqitur Kërkesën Referuese në anglishte. Për këtë arsye, gjuha e punës e këtij procedimi do të jetë anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara – shqipe, serbishte dhe anglishte – të mundësuar nga Zyra Administrative.
4. Më tej, Paneli vëren se, në pajtim me rregullën 15(2) të Rregullores, mund të kërkojë informacion shtesë ose parashtrime, nëse e gjykon të nevojshme, në lidhje me Kërkesën Referuese. Gjithashtu, sipas nenit 35(2)(i) të Ligjit, nëse Kërkesa Referuese ka të bëjë me ngritjen e një aktakuze nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), ZPS-ja ka autoritetin t'i përgjigjet Kërkesës Referuese.
5. Paneli e gjykon të arsyeshme të kërkojë parashtrime shtesë në lidhje me Kërkesën Referuese. Paneli do të lëshojë një vendim në lidhje me këtë në kohën e duhur, duke i bërë pyetje specifike ZPS-së dhe parashtruesit në lidhje me Kërkesën Referuese dhe afatin brenda të cilit ZPS-ja dhe parashtruesi mund të dorëzojnë parashtrimet e tyre

¹ KSC-CC-2022-14, F00001, Kërkesë Referuese e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publike, 28 shkurt 2022, me Shtojcën 1, publike.

² KSC-CC-2022-14, F00002, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 1 mars 2022.

në lidhje me pyetjet specifike. Për këtë arsye, Paneli gjithashtu i bën të ditur ZPS-së që të mos i përgjigjet Kërkesës Referuese derisa Paneli të ketë lëshuar vendimin në fjalë, i cili, sikurse u tha, do të specifikojë pyetjet dhe afatet për parashtrimet.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA,

Paneli i Gjykatës Kushtetuese

1. *Vendos* që gjuha e punës e këtij procedimi të jetë anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara – shqipe, serbishte dhe anglishte – të mundësuar nga Zyra Administrative;
2. *Bën të ditur* se, në kohën e duhur, Paneli do të lëshojë një vendim mbi parashtrimet shtesë të ZPS-së dhe të parashtruesit në lidhje me Kërkesën Referuese dhe afatet për dorëzimin e parashtrimeve nga ZPS-ja dhe parashtruesi.

/nënshkrimi/

Gjykatës Vidar Stensland

Kryegjykatës

Hartuar në anglishte, e enjte, 10 mars 2022

Në Hagë, Holandë